

# Parashikimi i Tregjeve Financiare për Vitin 2019



Letër e Hapur për Investitorët dhe Publikun

ARTON LENA  
CEO/CIO

KRISIAN ZAVALANI  
EQUITY SALES & TRADING /  
ASSISTANT TO THE CEO

## Tabela e Zhvillimeve

Hyrje .....	1
Perspektiva e Tregut.....	2
Pika Kyçe .....	3
Ngjarjet kryesore të Pritura në 2019.....	4
Statistika dhe Fakte .....	5
Përfundime, Disa Këshilla nga Ne për Ju. ....	6

# HYRJE

Të gjithë investitorëve,

Në mbyllje të vitit tonë te parë kalendarik, në WVP FUND MANAGEMENT TIRANA jemi krenarë që t`ju paraqesim këtë raport për herë të parë të gjithë ju që na besuat në këtë nisëm sa të vështirë, por aq edhe të bukur. Gjatë këtij viti kemi arritur shumë sëbashku, themelimin e FONDIT TË PARË TË INVESTIMEVE NË AKSIONE në historinë e Shtetit Shqiptar. Në vigjiljen e Vitit të Ri 2019 ne duam t`ju falenderojmë për besimin që na keni dhënë dhe gjithashtu t`ju urojmë për zgjedhjen tuaj dhe përparësinë e modernitetin e mentalitetit tuaj, gjë që e keni treguar duke përqafuar këtë formë investimi që fatkeqësisht, pavarësisht se është më e njohura në vendet e zhvilluara vazhdon të ngelet tabu në Ballkan.

Ky raport ka si synim të paraqesë një përmbajtje të analizës dhe pritshmërive tona për ambientin investues në 2019. Në përfundim të tij ju do të keni një ide më të qartë rreth mënyrës se si fondi do të menaxhojë asetet e tij dhe perceptimin tonë të rrisqeve të tregjeve, ato gjeopolitike, të politikave te ndjekuara nga Bankat Qëndrore te vëndeve ku fondi investon, cikleve te ekonomive botërore dhe luhatshmërisë së pritur të çmimeve.

Ne ju urojmë një vit sa më të mbarë në 2019 dhe jemi me ju për të bashkëpunuar në arritjen e objektivave tuaja financiare!

# Perspektiva e Tregut

Në këto momente që shkruajmë ambienti investues në të cilin kemi hyrë është vështirësuar dhe për 2019 besojmë se do të vazhdojë të jetë sfidues. Shkak i këtyre ngjarjeve janë;

1. Pasiguritë gjeopolitike
2. Politika Monetare më e ngushtuar
3. Cikli i rritjes ekonomike botërore po afron drejt maturimit;

Të gjitha ngjarjet e sipërpërmëndura të kombinuara së bashku, kontribuojnë në këtë ambient në të cilin ndodhemi. Siç do të njiheni më në detaje në faqet e mëposhtme, ne ende shohim mundësi atraktive për të investuar pavarësisht ambientit sfidues që na pret në 2019. Megjithatë ju, INVESTITORI, duhet të jeni të përgatitur që me afrimin e maturimit të ciklit rritës së ekonomisë botërore çmimet do të pësojnë luhatshmëri, gjë e cila ka filluar të haset që prej Tetorit 2018. Teksa tregjet në këto periudha bëhen më të pasigurta është shumë e rëndësishme që investimet tona dhe rrjedhimisht tuajat të jenë më të kujdesshme dhe i një kualiteti të lartë. Duke u nisur nga këto parime të përshkuara më sipër në mënyrë që ne të arrijmë rezultatet dhe objektivat tona strategjia jonë do të mbështetet dhe shtrihet në arritjen e : Likuiditetit, Cilësisë, Vlerës dhe Horizonit Afatëgjatë. Objektivi jonë kryesor do të jetë arritja e planeve të përshkuara në prospektin tonë duke synuar gjithmonë në përfitime afatgjata dhe jo anasjelltas, ndërkohë duke minimizuar riskun sa të jetë e mundur. Ne jemi të besimit se kjo strategji do të arrijë me sukses t'u shërbejë mirë ju investitoreve teksa cikli maturohet.

# Pikat Kyçe

Teksa shkruajmë, pikëpamja jonë mbetet që hyrja e vitit 2019 duhet t'i gjejë investoret më të ekspozuar në Aksione se sa Obligacione. Duke qenë se fondi është i angazhuar vetëm në investimin në Aksione, në këtë letër ne do të përqëndrohemi vetëm në analizën e kësaj klase asetesh. Siç e përmendëm më lartë, ne presim rritje të luhatshmërisë së çmimeve për shkak të zhvillimeve gjeopolitike, politikave të Bankave Qëndrore dhe cikleve ekonomike. Megjithatë indikatorët tipikë të konsumit, investimeve, dhe punësimit nuk sinjalizojnë ende shenja për një reçesion të mundshëm. Të dhënat fundamentale janë ende të shëndetshme dhe nuk shfaqin shenja për shqetësim për 2019. Inflacioni ende qëndron në nivele të ulëta, gjë që na bën të besojmë se tkurrja e politikave monetare të Bankave Qëndrore do të vazhdojë në mënyrë graduale. Shumë nga titujt, përfshirë aksionet, në gjykimin tonë tashmë e kanë reflektuar këtë gjë në çmimet e tyre duke na lënë të mendojmë se pavarësisht luhatshmërisë tregjet do të balanohen dhe madje disa prej tyre janë me çmime shumë të favorshme dhe të lira në këto momente.

Në pikëpamjen tonë frika e mbylljes së ciklit të rritjes ekonomike janë shkak kryesor i rënies së çmimeve së bashku me politikat e Federal Reserve FED (Banka Qëndrore Amerikane) dhe tensioneve të luftës së tarifave midis Amerikës dhe Kinës. Do të vini re në këtë analizë se një pjesë e rëndësishme e analizës tonë bazohet në tregjet Amerikane. Kjo gjë ndodh sepse për shkak të volumit të madh që U.S.A mban në tregjet botërore historia tregon se zhvillimet e këtyre tregjeve ndikojnë shumë dhe ndihen në tregjet botërore. Fondi gjithashtu ka një ekspozim prej 30% të aseteve të tij drejtpërdrejt në tregjet Amerikane. Në vijim do të ndiqni ngjarjet kryesore që presim në 2019 dhe të dhënat ekonomike dhe të tregut për të pasur një ide se si mund të luhaten çmimet e aksioneve në botë.

# Ngjarjet kryesore të Pritura ne 2019

Në muajt që vijojnë presim zhvillime kyçe që do të vendosin ecurinë e tregjeve;

1. Zgjedhjet Politike
2. Zgjedhjet e Bankave Qëndrore
3. Ulja e rritjes ekonomike;

Tensionet midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës janë ngjarja kryesore e cila do të ndikojë çmimet e aksioneve. Administrata Amerikane në gjykimin tonë ka ndjekur një politikë pro rritjes ekonomike. Megjithatë lufta për tarifatat kundrejt Kinës nuk e reflekton këtë politikë dhe në rast se marrëdhëniet do të vështirësohen, atëherë ju Investitori duhet të prisni një rënie të mëtejshme të çmimeve. Në rast se e kundërta ndodh atëherë presim një rritje të përgjithëshme të çmimeve të aksioneve.

Bankat Qëndrore kryesore sidomos FED tashmë kanë filluar të rrisin normat e interesit. Kjo gjë bëhet me qëllim për të ngadalësuar rritjen ekonomike më të shpejtë seç duhet në mënyrë që të mbahet nën kontroll inflacioni. Megjithatë inflacioni vazhdon në nivele të ulëta ashtu si para nisjes së këtyre politikave. Kostot e huamarrjeve po rriten por të dhënat e punësimit ngelen ende të forta. Këto sinjale duhet të cojnë në ngadalësimin e tkurrjes së politikave monetare nga Bankat Qëndrore, gjë që me shumë mundësi do të pritët mirë nga tregjet botërore. Në pikëpamjen tonë një tjetër rritje e interesave është e pajustificueshme për momentin.

Rritja ekonomike botërore pritët të vazhdojë, por me ritme më të ulëta në krahasim me 2018. Konkretisht do të bjerë nga 3.8% në 3.6%. Kjo do të vijë si pasojë e ngadalësimit që do të ndodhë në U.S.A nga mbarimi i efektit stimulus, i uljeve të taksave dhe rritja e normave të interesit. Në Europë parashikojmë kërkesë të brendshme të shëndetshme, por rënia e eksporteve nuk do të lejojë një rritje më të madhe ekonomike se 2018. Kina ndërkohë vuan presionin e dyfishit të tarifave me Amerikën dhe maturimin e ekonomisë së saj të brendshme.

**Parashikime dhe ngjarje të pritura në 2019.** Fitimet e kompanive Amerikane u rriten me 21% në 2018 për shkak të uljeve të taksave. Ato përbëjnë 50% të të gjithë fitimeve botërore të të gjithë kompanive. Në 2019 rritja pritet të jetë vetëm rreth 4% në U.S.A dhe 5% në Europë. Në të njëjtën kohë shumë ngjarje politike dhe elektorale janë të programuara në Europë dhe botë dhe secila prej tyre do të ketë një ndikim në tregjet financiare. Vende të cilat do të hynë në zgjedhje do të jenë: Afrika e Jugut, Greqia, Kanadaja dhe Argjentina. Europa do të votojë për Parlamentin European, Amerika do të fillojë fushatën elektorale presidenciale, ndërkohe që instabiliteti mund të provokojë referendume të tjera në Itali, Gjermani dhe Mbretërinë e Bashkuar.

**Inovacion në risqe dhe analiza.** Një tjetër faktor i ri risku ka lindur vitet e fundit. Rrjetet sociale kanë bërë të mundur që çdo kompani të kontrollohet nga popullata e gjërë dhe praktikrat e tyre të gabuara janë më lehtësisht të zbulueshme. Në këtë formë korporatat me qeverisje të gabuar apo ato të cilat me praktikrat e tyre dëmtojnë ambientin janë dënuar nga investitorët duke shitur aksionet e tyre dhe duke sjellë rënien e çmimit të këtyre kompanive në bursë.

**Një ngadalësim në ekonominë botërore.** Pas 10 viteve rresht rritjeje të bursave, tashmë duket se ka ardhur një moment rënie i cili është krejtësisht normal. Kjo nuk do të thotë që tregu sdo të rritet më, por thjesht na bën të mendojmë se stimujt që shtetet jepnin pas krizës financiare 2008 nuk janë më, dhe tani rritja e aksioneve do të jete në të njëjtën vijë me rritjen ekonomike botërore, sigurisht duke reflektuar një premium për shkak të rrezikut më të lartë që aksionet posedojnë në krahasim me asetet e tjera.

**Fillimi i një reçesioni nuk duket në horizontin tonë ende.** Të dhënat momentale të konsumit, investimeve dhe rritjes së punësimit vazhdojnë të jenë të qëndrueshme dhe larg atyre tipareve që hasim historikisht në një reçesion. Përsa i përket inflacionit, ne mendojmë se ai do të vazhdojë të jetë në norma të kontrolluara dhe Bankat Qëndrore do të vazhdojnë të ngadalësojnë rritjen ekonomike me programet e tyre tkurrëse. Përsa i përket politikave fiskale, qëndrimi ynë është i fillë që nuk presim të kemi ndryshime drastike. Për këto arsye kemi besimin se çmimet e lëndëve bazë do të qëndrojnë stabël dhe gjithashtu rregulloret e reja për kapitalizimin e bankave pas krizës së 2008-es, kanë krijuar tashmë institucione financiare shumë më stabël se një dekadë më parë. Ne besojmë se një reçesion i mirëfilltë mund të fillojë në fund të vitit 2020.

**Mundësitë për të gjetur Rritje dhe Vlerë ende ekzistojnë.** Pavarësisht ngadalësimit botëror, efektet nuk do të ndihen në mënyrë uniforme në të gjitha shtetet, sektorët apo kompanitë. Ne presim që firmat të cilat kanë modele biznesi të cilat ndikohen nga trende jo ciklike rritëse si rritja e popullsisë, plakja dhe urbanizimi të vazhdojnë të jenë performuese të mira në tregjet përkatëse. Investitori duhet të ketë parasysh që në çdo kohë ka gjithmonë mundësi për të gjetur vlerë edhe kur këto kohë mund të jenë krize apo reçesioni.

**Risku i zhvillimeve politike qëndron por është i diversifikuar.** Në gjykimin tonë një zhvillim i veçuar politik i një shteti zakonisht nuk ka ndonjë ndikim të madh në tregjet botërore në tërësi. Megjithatë tensionet e tarifave midis U.S.A dhe Kinës përbëjnë një përjashtim dhe është një risk që duhet marrë parasysh.


Prepare for the **BEAR!**





# Statistika dhe Fakte

US stock total returns 18-6 months before a recession, in %



Source: Bloomberg, Ibbotson, NBER, UBS, as of 6 November 2018

Të dhënat tregojnë se aksionet shohin rritje të mëdha në periudhat para reçesioneve. Një gjë e tillë tashmë ka ndodhur dhe investitorët duhet të jenë të përgatitur për luhatshmëri të lartë çmimesh.

## Tashmë jemi afër atij fenomeni që tregjet e njohin si Bear Market.

Një Bear Market ndodh kur çmimet kanë rënë minimumi 20% nga pika e tyre më e lartë e 52-javëve të fundit. Tashmë ne jemi në atë situatë dhe ju duhet të kuptoni që Bear Markets kanë ndodhur me dhjetra here në historinë e tregjeve financiare dhe janë një fenomen normal dhe i pritur. Për këto arsye ne mendojmë se dhe ky Bear Market do i ngjajë të tjerëve në histori me përjashtim Bear Markets të kohërave të krizave të cilët janë më të rendë. Investitori duhet të presë një rënie të çmimeve midis 25%-30% në aksionet e portofolit të fondit.

E kundërta e një këtij fenomeni quhet Bull Market, një periudhë kur çmimet e aksioneve rriten vazhdimisht. Momentalisht Bull Market në të cilin ndodhemi ka zgjatur për 10 vjet pa ndalim. Atij tani po i vjen fundi, me disa ekspertë duke deklaruar që tregjet janë futur tashmë në Bear Market. Megjithatë ju duhet të keni parasysh se Bull Markets nuk vdesin thjeshtë nga moshën. Për shkak të gjithë faktorëve të lartëpërmëndur më lart, tregjet janë shumë afër ose kanë hyrë në Bear Market.

Mundësia më e mirë që Bear Markets ofrojnë është blerja me çmime shumë të ulëta e aksioneve për investitorët e rregullt, gjë që çon në fitime shumë të kënaqëshme në horizont afatgjatë.

## Statistika mbi Bear Markets

Peak year	1946	1961	1968	1972	1987	2000	2007	Average
<b>US large-cap stocks</b>								
Length of prior bull market*	169	184	78	31	157	155	62	119
Time between market cycles**	204	190	84	50	179	158	87	136
Peak	Mar 1946	Dec 1961	Nov 1968	Dec 1972	Aug 1987	Aug 2000	Oct 2007	
Trough	Nov 1946	Jun 1962	Jun 1970	Sep 1974	Nov 1987	Sep 2002	Feb 2009	
Recovery date	Oct 1949	Apr 1963	Mar 1971	Jun 1976	May 1989	Oct 2006	Mar 2012	
Max drawdown	-21.8%	-22.3%	-29.4%	-42.6%	-29.6%	-44.7%	-51.0%	-34.5%
Time to full recovery (new all-time high)***	41	16	28	42	21	74	53	39
Drawdown time***	6	6	19	21	3	25	16	14
Recovery time***	35	10	9	21	18	49	37	26
Months of prior gains "erased"	15	36	66	118	18	64	141	65

Siç mund të shikoni nga të dhënat e kësaj tabele mesatarisht historia tregon se:

1. Mesatarisht rritja e vazhdueshme e tregjeve zgjat 119 muaj
2. Rënia mesatare ne Bear Markets është -34.5%
3. Kohëzgjatja mesatare e Bear Market është 14 muaj
4. Koha që duhet për t'u rikuperuar humbja është 26 muaj

# Portofoli i Kompanive Tona

Equity	Ticker
Apple Inc	AAPL.O
Allianz SE	ALVG.DE
AXA SA	AXAF.PA
BOEING	BA
BASF SE	BASFN.DE
Bayerische Motoren Werke AG	BMWG.DE
BNP Paribas SA	BNPP.PA
Daimler AG	DAIGN.DE
Diageo PLC	DGE.L
Deutsche Post AG	DPWGN.DE
Facebook Inc	FB.O
Fresenius SE & Co KGaA	FREG.DE
HeidelbergCement AG	HEIG.DE
Henkel AG & Co KGaA	HNKG_P.DE
ING Groep NV	INGA.AS
Lloyds Banking Group PLC	LLOY.L
Merck KGaA	MRCG.DE
Nestle	NESN.S
Pfizer Inc	PFE
Procter & Gamble Co/The	PG
Royal Dutch Shell PLC	RDSA.AS
Roche Holding AG	ROG.S
SANOFI SA	SASY.PA
Siemens AG	SIEGN.DE
Telefonica SA	TEF.MC
TOTAL SA	TOTF.PA
Unilever NV	UN.BE
UNITED TECHNOLOGIES CORP	UTX
Volkswagen	VOWG_P.DE
Walmart Inc	WMT
EXXON MOBIL CORP	XOM
Zurich Insurance Group AG	ZURN.S

Portofoli i kompanive tona përbëhet prej 32 Blue Chips Large Cap subjektsh. Siç mund të shikohet fondi mban pozicione në industri të ndryshme për të diversifikuar riskun si auotomive, farmaceutikë, teknologji, elektronikë, naftë dhe gaz, ushqimore, transport, sigurime, pije alkoolike, telekomunikacion, higjenë personale etj.

Të gjitha kompanitë e portofolit kanë një vlerë prej dhjetra ose qindra Biona Eurosh dhe janë lider në tregjet respektive ku ato operojnë.

# Pasqyra e Fondit në 1 Janar 2019

## WVP TOP INVEST [01.01.2019]


### Basic Parameters

Fund Start Date	29.03.2018
Initial Unit Price	1.000
Currency	ALL
Method of Profit Calculation	Weighted Average
Accrual Method	First Day Accrual
Units Outstanding	86.814,6820
Unit Price	897,7281 ALL
NAV	77.935.976,89 ALL
Assets	78.710.785,13 ALL
Liabilities	774.808,24 ALL
Net Payments	0,00 ALL
Capital Gain	-8.510,62 ALL

### Indicators

Volatility	11,71%
Sharpe'S Ratio	N/A
Modified Duration	0,00
<b>Returns</b>	
	%
Daily Return	-0,01
Weekly Return	2,16
Monthly Return	-7,42
Quarterly Return	-13,43
Current Quartal Yield	-0,01
Semi-Annual Return	-10,16
Annual Return	N/A
Year-To-Date Return	-0,01
Yield Since Founding	-10,23
Total Assets Under Mgmt.	77.935.976,89 ALL

Me fillimin e Bear market siç mund të vërehet dhe kompanitë e portofolit tonë janë ndikuar. Vlen për tu përmendur që falë diversifikimit ndërkohë që tregu në përgjithësi ka parë rënie me gati 25% vlera e fondit është ulur vetëm 10.23%. Kjo lëkundje qëndron totalisht brënda modeleve tona të riskut. Fondi ka arritur të mposhtë tregun në këtë rënie me performancë 150% më të mirë pavarësisht rënies në vlerë. Më poshtë në vijim do të gjeni dhe grafikun e lëvizjeve të çmimeve të kuotës tuaj sëbashku me vlerën totale të fondit.



## Top 10 Kompanite Tona

Top 10 Positions	ALL	%NAV		Currency Exposure	ALL	%NAV
PFE	3.458.370	<b>4,44</b>		EUR	42.465.940	<b>54,49</b>
PG	3.271.280	<b>4,20</b>		USD	21.987.803	<b>28,21</b>
DGE.L	3.072.711	<b>3,94</b>		CHF	8.104.135	<b>10,40</b>
SASY.PA	2.981.432	<b>3,83</b>		GBP	5.054.025	<b>6,48</b>
WMT	2.962.495	<b>3,80</b>				
NESN.S	2.867.995	<b>3,68</b>				
MRCG.DE	2.769.545	<b>3,55</b>				
ROG.S	2.667.116	<b>3,42</b>				
UN.BE	2.640.741	<b>3,39</b>				
BA	2.606.845	<b>3,34</b>				

Në fillim të këtij viti kjo tabelë paraqet 10 kompanitë me peshën më të madhe në asetet e fondit. Kjo listë është subjekt i ndryshimeve çdo ditë në varësi të bursave dhe vlerës individuale të çdo kompanie.

Një faktor i lartë risku për ne mbetet dhe qëndron fakti i kursit të këmbimit. Në këtë ambient që ndodhet Leku forcimi i tij ka sjellë humbje për fondin për shkak se të gjitha asetet janë të investuara në valutë. Si rrjedhojë çdo aset vlen më pak për shkak të shfuqizimit të monedhës në të cilën është kryer transaksioni. Megjithëatë ky faktor mund të tejkalohet nga rritja e vlerave të kompanive ashtu siç u faktua deri në fillim të muajit Nëntor para se rënia e bursave të merrte nismë.

Nga ana tjetër fuqizimi i lekut për investitorin është një përparësi sepse i mundëson atij të blejë më shumë kuota për një sasi të njëjtë parash.

# Përfundime, Disa këshilla nga Ne për Ju...

Në të gjithë historinë e tregjeve financiare 3 gjëra janë gjithmonë të sigurta:

1. Tregjet do të kenë GJITHMONË luhatshmëri
2. Në afatgjatë tregjet gjithmonë rriten sepse ekonomia botërore është gjithmonë në rritje
3. Gjatë periudhave të vështira frika është gjithmonë ngjitetëse

Ky investim që ju keni marrë përsipër duke na besuar ne, nuk ka qënë një zgjidhje e lehtë. E themi këtë duke marrë parasysh situatën dhe ambientin e tregjeve financiare në të cilin Shqipëria ndodhet. Ajo çka ne na shtyn për të ofruar këtë risi është pasioni dhe dëshira jonë për të modernizuar tregjet financiare Shqiptare dhe për t'i dhënë mundësi investitorëve të diversifikohen dhe modernizohen duke marrë pjesë në rritjen e ekonomisë botërore. Ne gjykimin tonë, ne mendojmë se tashmë edhe nga indikatorët makroekonomikë të Shqipërisë tregu vetë po shpreh nevojën e të tillave risive. Gjithëçka filloi me fondet e para të investimeve në obligacione dhe fondet e pensioneve. Ne jemi krenarë të jemi TË PARËT dhe momentalisht të vetmit që ofrojmë një fond në aksione.

Së bashku synojmë të kemi një marrëdhënie afatgjatë për dekada e dekada me radhë sepse ne jemi këtu për të qëndruar! Gjatë viteve do të shihni nga afër sesi tre pikat e lartëpërmëndura do të materializohen tek ju si investitorë, tashmë duke ndjekur investimin tuaj tek ne. Është e pashmangshme. Ajo çka është e rëndësishme të dini qëndron në faktin se, në këtë fushë durimi, pagesa e rregullt e planeve investuese dhe matura janë virtytet më të çmuara. Ju jeni të parët në këtë rrugë të vështirë, por aq shumë të nevojshme për vendin tonë.

**Kini parasysh se investimi në një aksion nuk është asgjë më shumë sesa blerja e një pjese të kompanisë. Ju jeni pronari!** E si i tillë mendojini luhatjet si pozitive ashtu dhe negative si një rrjedhë normale e çmimit në treg. Ashtu si çdo treg ku ju merrni pjesë dhe kryeni transaksione çdo ditë edhe në këtë treg çmimet nuk janë fikse. Ajo çka duhet të fokusoheni është investimi në një biznes solid, të qëndrueshëm dhe me një të ardhme të mirë të pritur. Këtë fazë, është nderi dhe përgjegjësia jonë për ta mbuluar. Ju tashmë e keni bërë pjesën tuaj dhe shumë më shumë duke sjellë risinë më të madhe të viteve të fundit në Shqipëri.

Nuk na mbetet gjë tjetër veçse t'ju falenderojmë pa masë dhe urojmë një **Vit të Shkëlqyer 2019!**